# Siguria në **komunitetin** tonë

Broshurë informuese mbi policinë në bashkësi në të gjitha rajonet e Policisë së Kosovës



osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**

KKSB ◆ OOBZ
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
OPŠTINSKI ODBOR ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**

KKSB ◆ OOBZ
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
OPŠTINSKI ODBOR ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE

# Parathënie



Të dashur miqë, të dashur partnerë të sigurisë në bashkësi,

Në këtë broshurë, e paraqesim punën e Policisë së Kosovës dhe komuniteteve lokale nëpër tërë Kosovën gjatë viteve të arritjeve të tyre të rëndësishme në krijimin e përmirësimit të sigurisë publike dhe të jetesës, të mbështetura nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Qëllimi i këtij publikimi është ngritja e vetëdijes për mekanizmat e sigurisë në bashkësi, duke ndihmuar bashkësitë lokale, policët dhe zyrtarët publik që ti kuptojnë përfitimet e bashkëpunimit për një të ardhme më të sigurtë të të gjithë banorëve të Kosovës.

Sigurimi i qëndrueshmërisë së këtyre mekanizmave është një sfidë kryesore e vendosur përpara të gjithëve neve. Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka mbështetur punën e forumeve të sigurisë në bashkësi për më shumë se 11 vjet. Ne e kemi bërë këtë punë për ta promovuar konceptin e policimit në bashkësi dhe për ta rritur sigurinë e bashkësive në përgjithësi. Pas gjithë këtyre viteve, jam i lumtur të njoftoj se këto forume e kanë përmirësuar vazhdimisht funksionalitetin dhe efektivitetin e tyre në sigurimin e sigurisë, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale dhe të bashkësive në Kosovë. Dëshiroj t'i përgëzoj përpjekjet e të gjithë vullnetarëve, zyrtarëve të policisë, udhëheqësve të fshatrave dhe kryetarëve të komunave, dhe t'i falënderoj për përkushtimin dhe angazhimin në punën e tyre.

Promovimi i parimeve të përgjegjësisë së përbashkët në sigurinë e bashkësisë dhe përfshirja e përfaqësuesve të të gjitha bashkësive në forumet e sigurisë në nivel lokal dhe komunal, është një parakusht për një shoqëri të sigurt, të qëndrueshme dhe të begatshme. Shoqëritë tona janë të gjitha të prekshme dhe të gjithë përjetojnë probleme dhe kërcënime. Sfidat socio-ekonomike dhe politike prekin të gjitha segmentet e jetës publike. Në vitet e fundit, një kërcënim në rritje është ai i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Të ballafaquar me këto kërcënime, shoqëritë tona do të jenë edhe më të prekshme nëse nuk bisedojmë me fqinjët tanë dhe nuk punojmë së bashku; nëse nuk flasim me të rinjtë tanë dhe nëse nuk i angazhojmë ata në luftimin e fenomeneve negative shoqërore.

Forumet e sigurisë në bashkësi luajnë një rol vendimtar në gjithë këtë proces. Për këtë arsye, ne e mbështetëm ngritjen e tyre dhe punuam për ta forcuar funksionalitetin e tyre gjatë këtyre viteve. Fonde të rëndësishme janë siguruar, për shembull, për Komitetet Lokale për Siguri Publike në tërë Kosovën, përmes Ambasadës Norvegjeze.

Duke shiquar në këto vite të mbështetjes së mekanizmave të sigurisë në bashkësi, do të thosha se rezultatet janë qartazi të dukshme. Ne kemi Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi që janë funksionale në çdo komunë në jug të lumit Ibër. Të gjitha ato funksionojnë pa përkrahjen e OSBE apo të organizatave tjera ndërkombëtare dhe ne kemi vërejtur se ata janë bërë mekanizma kyç për çështjet e sigurisë lokale. Në të njëjtën kohë, janë themeluar 60 Komitete Lokale për Siguri Publike në tërë Kosovën, duke i përfshirë edhe 11 KLSP-të në veri. Ato sigurojnë një vend të rëndësishëm për konsultime që kanë për bazë çështjet e sigurisë, veçanërisht në mjediset shumë-etnike. Si të tilla, ato janë gjithashtu të dobishme në aspektin e dialogut ndër-etnik dhe ndërtimit të besimit, si dhe në drejtim të shtrirjes institucionale të bashkësive. Funksionaliteti dhe qëndrueshmëria e tyre bazohen në vullnetin politik të akterëve kryesor, dhe ne rekomandojmë që komunat dhe qeverisja qendrore të bëjnë çmos për t'i fuqizuar dhe mbështetur ato.

Ne duhet të punojmë së bashku për të nxitur më tej bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet mekanizmave të ndryshëm të sigurisë në bashkësi dhe ne duhet t'i drejtohemi fqinjëve tanë në mënyrë që ata të përfshihen sa më shumë që të munden dhe të bashkohen me ne në këtë përpjekje.

Nga ana jonë, ne do të jemi të lumtur të vazhdojmë me kontributin tonë. Ne do të vazhdojmë të mbështesim institucionet relevante në zbatimin e Strategjisë së Sigurisë në Bashkësi dhe Planit të Veprimit dhe do të vazhdojmë t'ju ndihmojmë në promovimin e parimeve të përgjegjësisë së përbashkët, gjithëpërfshirjes dhe mbështetjes për bashkësitë, të rinjtë, gratë, grupet e margjinalizuara dhe të rrezikuara që i përkasin familjes së sigurisë në bashkësi.

Unë ju bëj thirrje të gjithëve që të bëni çmos që të angazhoni zyrtarët tuaj të policisë, udhëheqësit tuaj komunal, fqinjët tuaj dhe aktivistët vendor në rritjen e efektivitetit të forumeve të sigurisë në bashkësi dhe përmirësimin e sigurisë publike në interes të të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë. Siguria e përgjithshme dhe siguria lokale janë përgjegjësi e të gjithëve. Le të punojmë së bashku. Së bashku për komunitetin dhe sigurinë!

Jan Braathu
Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë


osbe
Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë
KOSOVO POLICE
POLICIA ËSHTË POPULLI
POPULLI ËSHTË POLICIA
KKSB ◆ OOBZ
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
OPŠTINSKI ODBOR ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE



# Lista e forumeve të sigurisë në të gjitha rajonet e Policisë së Kosovës

## PRISHTINË

♦ Prishtinë ○"Bërnicë e Poshtme ○"Keqekollë" ○"Prishtinë Qendra" ○"Hajvali" ○"Dardani"
♦ Fushë Kosovë ○"Fushë Kosovë" ○"Apollonia"
♦ Lipjan ○"Janjevë"
♦ Graçanicë ○"Gushtericë e Ulët" ○"Llapllasellë - Çagllavicë - Preoc" ○"Sushicë - Kishnicë - Badoc"
♦ Obiliq ○"Obiliq"
♦ Podujevë ○"Kërpimeh" ○"Orllan"
♦ Gllogoc

## PRIZREN

♦ Prizren ○"Mushnikovë" ○"Lubizhdë"
♦ Dragash ○"Krushevë"
♦ Suharekë
♦ Mamushë

## FERIZAJ

♦ Ferizaj ○"Bablak" ○"Zaskok"
♦ Shtime ○"Muzeqinë"
♦ Kaçanik ○"Kaçanik"
♦ Shtërpcë
♦ Hani Elezit

## GJAKOVË

♦ Gjakovë ○"Kolonia" ○"Rogovë" ○"Cërmjan"
♦ Rahovec ○"Rahovec"
♦ Malishevë ○"Malishevë"

## PEJË

♦ Pejë ○"Levoshë"
♦ Istog ○"Osojan"
♦ Klinë ○"Dollc - Dresnik" ○"Drenoc"
♦ Deçan
♦ Junik

## GJILAN

♦ Gjilan ○"Rruga Avdullah Presheva" ○"Livoç i Epërm" ○"Ponesh"
♦ Kamenicë ○"Kamenicë" ○"Berivojcë" ○"Muçivërc"
♦ Viti ○"Pozharan" ○"Smirë" ○"Kabash"
♦ Novobërdë ○"Labjan - Bostan"
♦ Kllokot ○"Vërboc - Gërnçar"
♦ Partesh ○"Partesh"
♦ Ranillug

## MITROVICË-VERIU

♦ Mitrovica Veriore ○"Kodra e Minatorëve", ○"Kroi i Vitakut" ○"Mahalla e Boshnjakëve"
♦ Zveçan ○"Zveçan, Sektor 1 i PK-së" ○"Zveçan, Sektor 2 i PK-së" ○"Lipë"
♦ Leposaviq ○"Bistricë" ○"Leshak" ○"Leposaviq"
♦ Zubin Potok ○"Çabër" ○"Zupç"

## MITROVICË-JUGU

♦ Mitrovica Jugore ○"Lagjja Roma Mahalla" ○"2. Korriku" - Sektor 1 i PK-së" ○"Shipol"
♦ Vushtrri ○"Preluzhë" ○"Gojbulë"
♦ Skenderaj ○"Runik - Syriganë - Baja" ○"Skenderaj"

**SIGURIA NË BASHKËSI** ka të bëjë rreth të qenit të sigurtë, qoftë në shtëpi, në rrugë apo në punë. Ajo ka të bëjë me cilësinë e jetës duke qenë në gjendje të ndjekë dhe të marrë përfitimet më të plota nga jeta juaj e brendshme, sociale dhe ekonomike pa pasur frikën apo pengesën nga krimi dhe prishja e rendit. Siguria në bashkësi jo vetëm që prek trajtimin e krimit dhe dukurive negative, por gjithashtu merr parasysh ndikimet shoqërore dhe mjedisore të një zone të përgjegjësisë. Përfshirja dhe partneritetet janë vlera kryesore në sigurinë e bashkësisë. Kur dëgjohen zërat e njerëzve lokal rreth çështjeve të policisë dhe sigurisë, bashkësitë bëhen më të sigurta, më të pastra dhe më të mira.

**POLICIMI NË BASHKËSI** është një filozofi dhe një strategji organizative që bazohet në përpjekjet e përbashkëta të banorëve dhe policisë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të bashkësisë. Siç përcaktohet nga Sir Robert Peel më 1829, policimi në bashkësi nënkupton "të ruajë gjatë tërë kohës një marrëdhënie me publikun që i jep realitet traditës historike se policia është populli dhe populli është policia: Policia është vetëm anëtare e popullit që paguhet për t'i kushtuar vëmendje të plotë atyre detyrave që janë të detyrueshme për çdo banor në interes të mirëqenies dhe ekzistencës së bashkësisë".

**STRATEGJIA E POLICIMIT NË BASHKËSI** ka si objektiv për të rritur bashkëpunimin midis banorëve dhe policisë nën moton "policia është populli dhe populli është policia". Strategjia promovon partneritetin midis publikut dhe policisë duke inkurajuar përgjegjësinë e tyre të përbashkët për çështjet e sigurisë në bashkësi. Ajo jep një rol vendimtar forumeve të sigurisë në bashkësi në identifikimin, komunikimin dhe adresimin e nevojave të bashkësive dhe në sigurimin që këto nevoja të bëhen qëllime të policisë.

**STRATEGJIA E SIGURISË NË BASHKËSI** përcakton prioritetet strategjike dhe objektivat e institucioneve të përfshira në sigurinë e bashkësisë, si parandalimi dhe zvogëlimi i krimit, rritja e pjesëmarrjes publike dhe rritja e vetëdijesimit për çështjet e sigurisë publike, si dhe lehtësimi i procesit të kthimit dhe mbrojtjes së bashkësive. Ajo harmonizon çasjet institucionale dhe bashkërendit veprimet e tyre, duke lejuar zbatimin e vizionit të saj për krijimin e një shoqërie paqësore shumë-etnike në të cilën njerëzit ndjehen të sigurt.

**RAJONET E POLICISË NË KOSOVË** Policia e Kosovës është e organizuar në nivel qendror dhe lokal. Nën Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë ekzistojnë tetë drejtori rajonale të policisë që përbëhen nga komunat përkatëse, duke përfshirë stacionet dhe nën-stacionet përgjegjëse policore. Këto rajone janë: Prishtina, Prizreni, Ferizaji, Gjakova, Peja, Gjilani, Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut.

**KO-ORDINIMI** Zyra Koordinuese për Siguri në Bashkësi (ZKSB) është themeluar nën kujdesin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) si një mekanizëm efektiv për adresimin e çështjeve të sigurisë në bashkësi përmes forumeve të sigurisë në bashkësi. ZKSB është mbështetur vazhdimisht dhe në mënyrë progresive nga Misioni i OSBE-së në Kosovë për të arritur kapacitete të qëndrueshme në koordinimin, udhëheqjen dhe fuqizimin e punës së të gjitha forumeve të sigurisë, si në nivel lokal ashtu edhe në atë komunal.

**NIVELI LOKAL** Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP) janë organe konsultative që bashkojnë përfaqësuesit e bashkësisë lokale, zyrtarët e policisë, zyrtarët komunalë dhe të shkollave, si dhe përfaqësuesit e grave dhe të rinjve që punojnë për ta përmirësuar sigurinë e bashkësisë dhe cilësinë e jetës në bashkësi. Anëtarët e KLSP-së i ngrenë çështjet e tilla si krimi, sjellja anti-sociale, çështjet mjedisore dhe çështjet të tjera që ndikojnë në sigurinë e bashkësisë.

**NIVELI KOMUNAL** Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) janë organe komunale që bashkojnë përfaqësuesit e institucioneve komunale, policisë, mediave, bashkësive etnike dhe fetare, si dhe organizatave të shoqërisë civile dhe kryetarët e KLSP-ve. Këto këshilla i këshillojnë komunat për çështjet e sigurisë publike dhe ofrojnë një forum për një debat gjithëpërfshirës për sigurinë në bashkësi dhe sigurojnë që nevojat e bashkësive lokale të bëhen shqetësime të komunës. Ato gjithashtu i ngritin çështje për të cilat KLSP-të nuk janë në gjendje ta tërheqin vëmendjen e komunës.

**NDËRTIMI I PARTNERITETIT** është një element thelbësor për krijimin e një bashkëpunimi efektiv midis organeve të ndryshme që punojnë në çështjet e sigurisë në bashkësi në Kosovë. Për ti rritur aftësitë e anëtarëve të KLSP-ve të sapokrijuara në krijimin e partneriteteve të reja në nivel lokal, komunal dhe qendror, ZKSB, e mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, i trajnon ato mbi parimet bazë të bashkëpunimit, pjesëmarrjes, gjithë-përfshirjes dhe qëndrueshmërisë. Përveç kësaj, një takim i Këshilli Ekzekutiv të KLSP-ve të lehtësuar nga OSBE mbahet dy herë brenda vitit, mbledh anëtarë e 60 KLSP-ve të themeluara në tërë Kosovën, ku promovon bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacioneve midis KLSP-ve. Këta anëtarë gjithashtu diskutojnë mësimet e nxjerra dhe inkurajojnë zbatimin e praktikave më të mira në të ardhmen.

**ZGJIDHJA E PROBLEMIT** Pasi anëtarët e KLSP-së kanë përfituar aftësitë për të ndërtuar partneritete dhe kanë filluar krijimin e tyre, ata njoftohen edhe me aftësitë e zgjidhjes së problemeve. ZKSB dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë i trajnon ata se si ta aplikojnë modelin e zgjidhjes së problemeve SARA që paraqet shkurtesën për skanimim e problemit (Scanning), analizën e problemit (Analysys), në reagimin ndaj problemit (Response) dhe vlerësimi i suksesit në zgjidhjen e problemit (Assessment)). Duke i pajisur ata me njohurinë për të adresuar çështjet e krimit, sigurisë dhe jetesës në bashkësitë e tyre përkatëse. Anëtarët e KLSP janë gjithashtu të trajnuar se si të zhvillojnë planet e veprimit të projektit që mund të zbatohen brenda bashkësive të tyre. Duke zbatuar këto aftësi të reja, KLSP-të janë në gjendje të kontribuojnë në sigurinë në bashkësive të tyre në një mënyrë të pavarur dhe të qëndrueshme.

**PËRFITIMET E BASHKËSISË** KLSP-të dhe KKSB-të u japin zë individëve dhe grupeve të interesit për çështjet e sigurisë në bashkësi, duke vepruar si forume ku ata mund të angazhohen dhe të ngrenë shqetësime apo çështje të sigurisë, në mënyrë që të merren në mënyrë pro-aktive me ta. Kjo shpie në parandalimin dhe reduktimin e kërcënimeve dhe krijon një bashkësi paqësore dhe të sigurt. Duke u mundësuar zbatimin e projekteve të bashkësisë bazuar në nevojat lokale, puna e këtyre forumeve të sigurisë në bashkësi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e përgjithshme të anëtarëve të bashkësisë:

- Studentët dhe të rinjtë kanë një mundësi unike për ta dëgjuar zërin e tyre dhe për të kontribuar për një mjedis më pozitiv;
- Prindërit mund të sugjerojnë projekte që rrisin sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre;
- Të moshuarit mund të ofrojnë përvojën dhe njohuritë e tyre për mënyrat për të ngritur çështje që ndikojnë në popullatën e vjetër;
- Bashkësitë e ndryshme mund të përdorin KLSP-të si një forum për të komunikuar shqetësimet e tyre të sigurisë, por gjithashtu për të inkurajuar integrimin, proceset e kthimit dhe shkëmbimet pozitive me bashkësinë e më gjerë;
- Sipërmarrësit privatë mund të përfitojnë nga një mjedis më pozitiv dhe i sigurt për bizneset e tyre si rezultat i punës së KLSP-ve;
- Organizatat joqeveritare (OJQ) mund ti përdorin shkathtësitë e tyre të ekspertizës dhe të zgjidhjes së problemeve në mbledhjet e bashkësisë në mënyrë që të ndryshojnë qasjen dhe fokusimin në fushat e tyre. Partneriteti me KLSP-të u lejon atyre të aplikojnë për financim dhe donacione për projektet e bashkësisë.

**RAPORTIMI I MEDIAVE** dhe reflektimi i publikut mbi çështjet e ngutshme mund të ndihmojnë në vënien në dyshim të koncepteve dhe ideve të vendosura, duke përfshirë cilësinë e shërbimit policor dhe komunikimin ndërmjet të gjithë akterëve brenda një komuniteti përkatës. Informacioni i duhur dhe në kohë është vendimtar për angazhimin e banorëve dhe bashkëpunimin e mirë në terren. Gazetarët dhe mediat mund ti rrisin njohuritë e popullatës në zgjidhjet e sigurisë në bashkësi, planet dhe projektet, përderisa ato kontribuojnë në përmirësimin e bashkëpunimit në terren përmes lajmeve ditore dhe raportimit mbi çështjet e sigurisë.

**SHOQËRIA CIVILE** luan një rol jetësor në nxitjen e ideve të reja, politikave, programeve ose strategjive për ndryshime shoqërore, duke i mbajtur zyrtarët publikë të përgjegjshëm në angazhimet e tyre dhe duke i identifikuar problemet si: mungesa e burimeve apo e vëmendjes nga niveli qendror. Organizatat e shoqërisë civile janë kujdestarët e të varfërve dhe të pambrojturve, duke siguruar që krijuesit e politikave të mos i harrojnë ato. Si i tillë, kontributi i përfaqësuesve të tyre në forumet e sigurisë në bashkësi është i paçmueshëm.

**RINIA** mund të zhvillojë praktika të mira të punës me angazhimin e tyre brenda një KLSP-je si një bazë - themeli e çmuar për kadetët e ardhshëm që synojnë të ndjekin një karrierë në policimin në bashkësi. Përmes rrjeteve sociale, ngjarjeve publike dhe iniciativave për rritjen e vetëdijesimit, të rinjtë mund ta mbështesin njëri-tjetrin në luftën kundër ngacmimit, përdorimit të drogës, sjelljeve anti-sociale dhe kriminale që kërcënojnë sigurinë dhe zhvillimin e tyre.

**GRATË** munden në mënyrë aktive të promovojnë fshatra dhe qytete më të sigurta dhe të kontribuojnë në parandalimin e dhunës dhe krimit që i prek ato për shkak të gjinisë së tyre. Çasjet e tyre për pjesëmarrje në forumet e sigurisë lokale dhe komunale u mundësojnë grave dhe vajzave që ta rrisin rolin e tyre në vendimmarrje, ndryshojnë politikat, sjelljet dhe qëndrimet në sferat private dhe publike.

**VULLNETARIZMI** në forumet e sigurisë në bashkësi mund të nxis përfshirjen e bashkësisë në sigurinë publike dhe të kontribuoj në proceset e vendimmarrjes. Ata që jetojnë dhe punojnë në një zonë përkatëse mund ti përdorin përvojat, aftësitë dhe njohuritë e tyre për ta ndihmuar dhe mbështetur policinë, shërbimet publike dhe grupet e cenueshme, për ta përmirësuar sigurinë dhe kushtet e jetesës në lagjet e tyre.

**PËRFSHIRJA** Për të mësuar më shumë rreth forumeve të sigurisë në bashkësi, policimit në bashkësi dhe mënyrave për t'u përfshirë në to, ju lutemi të kontaktoni me zyrtarin tuaj të policisë, përfaqësuesit lokal dhe komunal që të kontribuoni për lagje më të sigurta dhe të ardhme më të sigurt për fëmijët tanë. Ju do të gjeni informacione të dobishme të kontaktit në fund të secilës faqe duke i paraqitur rajonet e Policisë së Kosovës.



**FILOZOFIA E POLICIMIT NË KOMUNITET** Parakushti kryesor i policimit në komunitet është që niveli i pjesëmarrjes së komunitetit në forcimin e sigurisë dhe rendit social dhe në zgjidhjen e krimit që ndërlidhet me komunitetin duhet rritur pasi që policia nuk mund ta përmbushë këtë detyrë si e vetme.

Për ta nxitur publikun që ta marrë përsipër pjesën e vet të përgjegjësisë në përmirësimin e cilësisë së jetesës në komunitet duke mbështetur kështu aktivisht përpjekjet e policisë për ta kontrolluar dhe parandaluar krimin, policia duhet ta ndërtojë besimin dhe zhvillojë partneritet me publikun. Ky partneritet duhet të karakterizohet nga një reagim reciprok dhe nga një pozitë e barabartë për të dy partnerët.

Për ta arritur këtë partneritet, policia duhet të integrohet më mirë në komunitet dhe ta forcojë legjitimitetin e saj në komunitet përmes policimit të bazuar në pëlqim dhe përmirësimit të shërbimit të tyre ndaj publikut.
Kështu që policia në komunitet duhet:

- të jetë e dukshme dhe e arritshme për publikun;
- ta njohë dhe të njihet nga publiku;
- t'u përgjigjet nevojave të komunitetit;
- të dëgjojë shqetësimet e komunitetit;
- të angazhohet dhe ta mobilizojë komunitetin;
- të japë llogari për veprimtaritë e saj dhe për rezultatet e këtyre veprimtarive.



**Dukshmëria dhe qasja** kërkojnë që punonjësit e policisë të jenë lehtësisht të arritshëm për anëtarët e komunitet përmes krijimit të një pranie të dukshme dhe jo kërcënuese në lagjet që mbulojnë. Kontaktet personale të përditshme gjithashtu do të ndihmonin që komuniteti të njihet dhe mësohet me policët e tyre.

Punonjësit e policisë duhet ta njohin përbërjen shoqërore të komuniteteve të tyre. Kështu ata duhet të krijojnë "harta sociale" të lagjeve ku ata janë caktuar, duke renditur, për shembull, banorë dhe grupe të pambrojtura, persona problematikë dhe kriminelë, vatra krimi (p.sh. lokalet) dhe zonat e nxehta, drejtuesit e komunitetit, llojet e bizneseve në zonë dhe objektet shoqërore.

**Reagimi** është një parim themelor i policimit demokratik, që do të thotë se policia u përgjigjet nevojave dhe shqetësimeve (të menjëhershme) të të gjithë anëtarëve të publikut dhe përpiqet të japë një shërbim të shpejtë dhe në mënyrë të barabartë e të paanshme, duke treguar ndjeshmëri ndaj atyre në nevojë dhe respekt për të drejtat e njeriut. Shërbimet e tyre duhet të jenë në përputhje me normat dhe vlerat e komunitetit dhe me nevojat individuale të pjesëtarëve të komunitetit ku policia vepron.

Koncept kryesor në policimin në komunitet është 'konsultimi me komunitetin'. Nevoja për konsultim me komunitetin bazohet në njohjen që një polici e mbyllur që vendos në mënyrë të njëanshme se cilat janë nevojat e komunitetit nuk do të jetë e suksesshme. Konsultimi, angazhimi dhe mobilizimi i komunitetit në identifikimin e problemeve të komunitetit, analizimin e shkaqeve kryesore të problemeve dhe vendosjen e prioriteteve për veprim si dhe implementimin e këtyre veprimeve janë gjithashtu aspekte thelbësore dhe tipar strategjik e dallues i qasjes pro-aktive të policimit në komunitet për zgjidhjen e problemeve. Përmes këshillimeve, policia demonstron që shqetësimet, vlerat dhe këshillat e komunitetit do të merren parasysh. Si shkëmbim, komuniteti pritet të japë informacion, burime dhe mbështetje morale për veprimtaritë e policisë. Në fakt, komuniteti duhet të jetë partner aktiv i policisë për evidentimin dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Llogaridhënia dhe transparenca, që janë gjithashtu parime qendrore të policimit demokratik, kërkojnë që policia të jetë e hapur për vëzhgim të veprimtarisë së saj – përfshirë sjelljen individuale të zyrtarëve policor, strategjive për operacionet policore, procedurave të emërimit dhe menaxhimit të buxhetit – nga një sërë institucionesh mbikëqyrëse. Policia gjithashtu me vullnetin e saj duhet t'i japë publikut informacion dhe garanci. Policia duhet të përgjigjet para ligjit dhe të japë llogari dhe të jetë transparente para publikut. Nëse policia është e gatshme për të qenë transparente rreth operacioneve të saj, atëherë komuniteti ka edhe më shumë gjasa për të qenë më përkrahës përballë problemeve (për shembull sjellja e papërshtatshme nga ana e një zyrtari të policisë, çështja e buxhetit, etj.)[1]

**PËRFITIMET PËR PUBLIKUN, POLICINË DHE AGJENCITË E TJERA** Nëse policimi në komunitet implementohet me sukses, publiku dhe policia do të gëzojnë një sërë përfitimesh. Komunitetet janë të afta të përcjellin shqetësimet e tyre te policia dhe të bëhen partnerë në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për problemet e tyre, gjë që nga ana tjetër mund të sjellë një përmirësim të parandalimit të krimit, siguri të përmirësuar dhe një ndjesi të përforcuar sigurie. Përfshirja e komunitetit mund të sjellë gjithashtu forcim të lidhjeve shoqërore si dhe kontroll joformal të shoqërisë brenda komuniteteve. Komunitetet që janë bashkuar me qëllimin e përbashkët për të arritur përmirësim të sigurisë, rendit dhe jetesës, shumë shpejt mund të fillojnë të ndërtojnë marrëdhënie afatgjata pavarësisht nga dallimet etnike, racore, fetare, apo politike. Këto marrëdhënie gjithashtu mund të forcojnë aftësinë e komuniteteve për t'u bërë ballë problemeve dhe presioneve sociale të cilat mund të sjellin kriminalitet apo çrregullim në të ardhmen. Më tej, partneriteti polici-publik mund të sjellë marrëdhënie të përmirësuara mes policisë dhe publikut, duke rritur kështu besimin e publikut, veçanërisht i rëndësishëm është në marrëdhënien mes policisë dhe komuniteteve të pakicës që në të kaluarën kanë qenë të rënduara nga konflikti.

Agjenci të tjera shtetërore gjithashtu përfitojnë nga pjesëmarrja e tyre në policimin në komunitet. Duke ndërtuar sinergji me agjenci të tjera dhe duke plotësuar punën e tyre, ato mund të kursejnë burimet për trajtimin e problemeve sociale. Gjithashtu, adresimi i problemeve sociale me sukses kursen shuma të konsiderueshme financiare (vandalizëm, kujdesi pasues për viktimat, etj.). Policia mund të mbledhë më shumë informacion, mbështetje të përgjithshme morale për veprimet policore – edhe për veprimet e ashpra – nëse komunitetet kuptojnë pse po ndërmerret një veprim i caktuar – dhe respekt nga qytetarët që i binden ligjit, madje edhe në ato komunitete që kanë refuzuar të bashkëpunojnë me policinë në të kaluarën për shkak të marrëdhënieve të tensionuara. Si përfundim kjo mbështetje mund të sjellë ndihmë për të luftuar krime më të rënda dhe të organizuara dhe tregje/ekonomi kriminale. Duke qenë se koncepti i policimit në komunitet ofron alternativa të reja për mbledhjen e informacionit, aftësi të reja ndër-personale, avantazhe të zgjidhjes së problemeve me ndihmën e teknologjisë dhe veprime parandaluese ndaj elementëve më tradicionalë të policimit reaktiv (përfshirë aftësinë për t'iu përgjigjur krizave të menjëhershme), veprimtaritë e policisë bëhen më efektive dhe efikase, duke ndihmuar madje edhe në zgjidhjen e krimeve komplekse.

Kështu, ndryshe nga perceptimet e gabuara që artikulohen ndonjëherë, policimi në komunitet nuk është aspak i butë ndaj krimit. Për më tepër, vetëm përmes ndërthurjes së përpjekjeve tradicionale policore me filozofinë e policimit në komunitet mund të arrihet siguria dhe rendi afatgjatë. Punonjësit e policisë që përjetojnë përballje më pozitive me publikun si rezultat i partneriteteve polici-komunitet kanë një ndjesi më të madhe të kënaqësisë në punë. Ka më pak të ngjarë që ata të përjetojnë mentalitetin "ne kundër atyre" dhe mund të gëzojnë përmirësimet e marrëdhënieve polici-komunitet po aq sa dhe komunitetet. Ndërsa punonjësit e policisë njihen më mirë me komunitetet e tyre, ata familjarizohen edhe me zonat e nxehta dhe kështu janë më të aftë të vlerësojnë rreziqet e vërteta, gjë që mund t'u japë atyre më shumë vetëbesim dhe të përforcojë ndjesinë e sigurisë personale.

Një marrëdhënie e shëndoshë personale me anëtarët e komunitetit mund ti mobilizojë gjithashtu qytetarë që ta respektojnë ligjin që ta japin mbështetjen dhe madje edhe ndihmën e tyre të drejtpërdrejtë, nëse shohin policin "e tyre" në rrezik. Përgjegjësitë e përbashkëta në mbarë policinë dhe rritja e komunikimit dhe e bashkëpunimit mes departamenteve si dhe mes oficerëve të vijës së parë dhe eprorëve të tyre sjellin një përmirësim të përgjithshëm në klimën e punës brenda policisë. Si përfundim, gama më e gjerë e detyrave si dhe përgjegjësitë e rritura e bëjnë punën më interesante, dhe nga ana tjetër, ofrojnë më shumë mundësi për zhvillimin e karrierës pasi personeli është i vlefshëm në shumë mënyra.[2]

1. Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik (qershor 2008), faqe 23-25. http://www.osce.org/sq/secretariat/32549?download=true
2. Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik (qershor 2008). faqe 33-34.




**POLICIMI NË BASHKËSI DHE SIGURIA E BASHKËSISË NË KOSOVË** Forumet e sigurisë në bashkësi, përkatësisht Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP) dhe Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) janë mekanizma të rëndësishme për reduktimin dhe parandalimin e krimit dhe shumë të vlefshëm në procesin e pajtimit ndëretnik në Kosovë. Bazuar në premisën se Policia është Populli dhe Populli është Policia, Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka mbështetur përmirësimin e situatës së sigurisë në bashkësi në tërë Kosovën për më shumë se një dekadë. Misioni i OSBE-së vazhdon angazhimin e tij për ta shtuar policimin në bashkësi dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike duke ofruar mbështetje në zhvillimin e institucioneve të nivelit qendror, mekanizmave komunal dhe lokal si dhe forumeve të tyre të sigurisë si organe konsultative dhe efektive në adresimin e çështjeve të sigurisë në bashkësi.

Misioni i OSBE-së ka lehtësuar krijimin dhe ka ndërtuar kapacitete për këto forume të sigurisë, duke i ndihmuar ato që ti adresojnë nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve të tyre, si dhe për të arritur qëndrueshmërinë. Inicimi dhe mbajtja e partneriteteve policore-publike kërkon vëmendje të veçantë për barazinë gjinore, përmirësimin e vetëdijes së sigurisë publike, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së sigurisë së bashkësisë në Kosovë. Me fuqizimin progresiv dhe të vazhdueshëm të partnerëve tanë kryesor dhe institucional, Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, së bashku e nxisim zbatimin e strategjive dhe planeve përkatëse të veprimit, duke ndërtuar kapacitetet e qëndrueshme të sigurisë në nivel lokal, komunal dhe qendror për të marrë përsipër menaxhimin në të ardhmen të arritjeve të punës që e ka bërë deri më tani Misionit i OSBE-së.

**NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË FORUMEVE TË SIGURISË NË BASHKËSI** Që nga viti 2006, programi për ngritjen e kapaciteteve i Misionit të OSBE-së në Kosovë i mbështet forumet e sigurisë në bashkësi me qëllim të zhvillimit të njohurive dhe aftësive të anëtarëve të saj që në mënyrë efektive ti adresojnë çështjet e krimit, sigurisë dhe jetesës. Programi fokusohet në këto parime kryesore: bashkëpunimi, pjesëmarrja, përfshirja dhe qëndrueshmëria. Kjo arrihet përmes realizimit të 1) Trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve për KLSP-të e reja, 2) Organizimi i takimeve të komunitetit me qëllim të futjes së anëtarëve të rinj të KLSP-e në bashkësitë e tyre dhe krijimit të lidhjeve të komunikimit ndërmjet anëtarëve të KLSP-së, përfaqësuesve të bashkësisë dhe akterëve të ndryshëm 3) Trajnimi për trajnerët e sigurisë në bashkësi në mënyrë që të rrisin aftësitë e trajnimit dhe lehtësimit të KLSP-ve për fuqizimin e qëndrueshëm të aktivistëve të tyre dhe 4) Organizimin e takimeve të Këshillit Ekzekutiv të KLSP-ve me qëllim të sigurimit të komunikimit dhe rrjetëzimit të rregullt në të gjitha rajonet e policisë në mbarë Kosovën. Në mënyrë të ngjashme, anëtarët e forumeve komunale dhe zyrtarët e policimit në bashkësi janë të përkrahur me kurse trajnimi dhe seminare në adresimin e sfidave dhe mënyrave të veçanta që shpiejnë përpara, e posaçërisht, me vëmendje të përqendruar në trajtimin e fenomeneve negative dhe shqetësimeve të sigurisë të grupeve të cenueshme, grave, të rinjve dhe komuniteteve etnike.







**MBËSHTETJA E PARTNERITETIT POLICORO-CIVIL** Që nga viti 2012, Misioni i OSBE-së e përkrah Grupin Drejtues për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë së Sigurisë në Bashkësi dhe Planit të Veprimit, si dhe ZKSB-së të themeluar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) me mandatin për të bashkërenditur dhe ndihmuar punën e KLSP-ve dhe KKSB-ve. Së bashku, kemi ndërtuar një strukturë mbresëlënëse të forumeve të sigurisë në bashkësi gjatë dekadës së fundit dhe ne gradualisht po e dorëzojmë programin e ndërtimit të kapaciteteve në MPB. Deri më sot, shumica e forumeve të sigurisë në bashkësi janë funksionale dhe përfshihen në mënyrë progresive në përmirësimin e sigurisë në bashkësi. Ata punojnë së bashku në këtë strukturë që i tubon kryesuesitë KLSP-ve nga niveli bazë dhe i avancon drejt e në KKSB-të përgjegjëse, ku kryetarët e komunave marrin përgjegjësinë për sigurimin e sigurisë në nivel komunal së bashku me komandantët e stacioneve të policisë dhe raportojnë në asamblet komunale dhe ministritë përkatëse.

**KONFERENCA E KKSB-SË DHE MBËSHTETJA E SIGURISË NË BASHKËSI**
në nivelin komual Misioni i OSBE-së në Kosovë rregullisht mbështet dhe e lehtëson Konferencën vjetore me Kryetarët si Udhëheqësa të KKSB-ve, të organizuar nga MPB-ja. Në këtë rast, kryetarët e komunave dhe akterët kryesor të sigurisë në bashkësi në nivel komunal, dhe pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë të Policisë së Kosovës dhe anëtarëve të Grupit Drejtues për Zbatimin e Strategjisë së Sigurisë në Bashkësi dhe Planit të Veprimit, shkëmbejnë informacione rreth performancës së KKSB- zhvillimet në lidhje me zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizimit të Dhunshëm që shpiejnë në Terrorizëm (ERDhShT), dhe diskutojnë se si të krijojnë lidhje dhe rrjete më të forta drejt një bashkëpunimi më të mirë të forumeve të sigurisë në bashkësi, duke çuar në krijimin e lidhjes më të ngushtë me qeverisjen qendrore.





**KËSHILLI EKZEKUTIV I KLSP-SË** Në mënyrë që të sigurohet një komunikim i rregullt në mes të KLSP-ve në tërë Kosovën, Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron mbështetje dhe lehtësim në takimin e Këshillit Ekzekutiv të KLSP-ve, organizuar nga Policia e Kosovës. Ky mekanizëm koordinimi që përfshin përfaqësuesit e të gjitha KLSP-ve i mundëson dhe i ndihmon ata të ndajnë informacione rreth aktiviteteve dhe projekteve të tyre, duke i ndihmuar ata që të zhvillojnë strategji të përbashkëta për të adresuar probleme të ngjashme. Takimet e Këshillit Ekzekutiv organizohen me një fokus kryesor në sigurimin e qëndrueshmërisë së KLSP-ve si sfida më thelbësore për sigurinë e bashkësisë në Kosovë.

# RAJONI I PRISHTINËS



**INFORMACIONE THEMELORE:** Sipërfaqja totale është 2.140,82 $km^2$. Popullsia 470.583 banorë. Numri i të punësuarve: 1100 zyrtarë policorë. Stacionet policore: Qendra, Jugu, Veriu, Fushë Kosovë, Lipjan, Graçanicë, Obiliq, Podujevë, Gllogoc dhe Njësia e Trafikut Rajonal e vendosur në Fushë Kosovë. Mbulon territorin e shtatë komunave.



KKSB-ja është një nga mekanizmat më të rëndësishëm që adreson çështjet e sigurisë publike me pjesëmarrjen e rëndësishme të shoqërisë civile që kontribuon në politikat dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Sfidat, rreziqet dhe kërcënimet moderne nuk karakterizohen vetëm si probleme për policinë, pasi siguria publike nuk mund të garantohet vetëm nga njëra palë. Nevojat e ndërlidhura të sigurisë të bashkësive të ndryshme politike kërkojnë një angazhim të përbashkët të të gjithë mekanizmave në qasjet e tyre për zgjidhjen e problemeve.
**– nënkolonel Rexhep Sijarina, drejtor rajonal.**



Përmes Strategjisë së Policimit në Bashkësi synojmë ta jetësojmë moton "Policia është Populli dhe Populli është Policia", duke afruar bashkëpunimin më të sinqertë në mes policisë dhe qytetarëve në zgjidhjen e problemeve dhe brengave të tyre.
**– nënkolonel Afrim Ahmeti, zëvendës drejtor rajonal.**



Anëtarët e KLSP-së sonë në bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësive lokale, komuniteteve jo shumicë, komunitetit fetar, forumit rinor dhe forumit të gruas, si dhe me përfaqësuesit e OJQ-së në Bërnicë të Poshtme kanë arritur nivelin e bashkëpunimit dhe të mirëbesimit që ka rezultuar me rezultatet të shkëlqyera të punës së policimit në bashkësi në zonën tonë të përgjegjësisë.
**– Hetem Kupina, kryesuesi i KLSP-së nga Bërnicë e Poshtme**



Partneriteti është një veti e bashkëpunimit në dobi dhe në të mirën e banorëve që të arrihet siguria dhe një formë më e lartë e përparimit nëpërmjet partneritetit polici – publik. Siguria dhe stabiliteti janë faktor shumë të rëndësishëm për një shoqëri të mirë.
**– Xheladin Fazliu, zëvendës kryesues i KLSP-së nga Hajvalia.**



Siguria, në çdo kuptim të fjalës, duhet të jetë prioritet i të gjitha bashkësive. Me angazhimin tonë në KLSP, ne krijojmë një mundësi solide dhe transparente për punën ekipore me policinë dhe komunën për ta përmirësuar sigurinë tonë. Vetëm së bashku, si një ekip mund të kemi sukses në këtë, sepse paqja dhe stabiliteti janë të paçmueshme.
**– Snezhana Jovanoviq, kryesuesi i KLSP-së nga Sushicë-Kishnicë-Badoc.**

# PRISHTINË



1. "Bërnicë e Poshtme", Prishtinë
2. "Keqekollë", Prishtinë
3. "Prishtina Qendra", Prishtinë
4. "Hajvali", Prishtinë
5. "Dardania", Prishtinë
6. "Fushë Kosovë", Fushë Kosovë
7. "Lagjja Apollonia", Fushë Kosovë
8. "Janjevë", Lipljan
9. "Gushtericë e Poshtme", Graçanicë
10. "Llapllasellë - Çagllavicë - Preoc", Graçanicë
11. "Sushicë - Kishnicë - Badoc", Graçanicë
12. "Obiliq", Obiliq
13. "Kërpimeh", Podujevë
14. "Orllan", Podujevë

**Gjithsej anëtarë** 135 **Meshkuj** 115 **Femra** 20

**Gjithsej projektet e financuara (2013 - 2017)** 97.965 EURO nga **Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze e të implementuara përmes OSBE-së**



KLSP-ja Qendra e Prishtinës ka bashkëpunim efikas me komunën dhe me zyrtarët e policisë në bashkësi duke krijuar një urë-lidhëse për të gjithë, në mënyrë që së bashku të ju ofrojmë shërbime dhe ambient sa më të sigurt të gjithë banorëve. Ne, kemi identifikuar probleme të shumta në bashkësi dhe i kemi adresuar tek institucionet përgjegjëse. Pjesa më e madhe e këtyre problemeve janë menaxhuar dhe zghidhur në bashkëpunim brenda një afati të shkurtër.
**– Violeta Hasani, kryesuesi i KLSP-së nga Prishtina Qendra.**



Zyrtarët tanë të policisë në bashkësi, në bashkëpunim me banorët janë më efikas në zgjidhjen e problemeve në lagjen dhe bashkësinë tonë. Përmes policimit në bashkësi dhe aktorëve të tjerë, siç janë forumet e sigurisë dhe rrjetet rinore, ne sigurojmë një ambient të sigurt dhe të qetë për të gjitha bashkësitë tona.
**– Bahri Bislimi, kryesuesi i KLSP-së nga Fushë Kosova.**



Me stafin tim të zjarrfikjes punojmë së bashku me forumet e sigurisë, me përfaqësuesit e komuniteteve etnike, fetare, OJQ-ve, Policinë e Kosovës dhe organet e pushtetit lokal në shpëtimin e jetës dhe pronës së qytetarëve në zonën tonë të përgjegjësisë.
**– Haqif Rrustemi, drejtor i Shërbimit të zjarrfikjes dhe koordinator i KKSB Lipjan.**

♦ **Prishtinë**: ○*"Bërnicë e Poshtme"*: Kryesuesi Hetem Kupina, 044 175 541, hetem.kupina@rks-gov.net. Zëvendës kryesuesi Branislav Gjoshiq, 044 426 583. ○*"Keqekollë"*: Kryesuesi Ilmi Uka, 044 357 642. Zëvendës kryesuesi Islam Isufi, 044 199 594, islamisufi1@hotmail.com. ○*"Prishtinë Qendra"*: Kryesuesi Violeta Hasani, 044 450 671, violetaaa-@hotmail.com. ○*"Hajvali"*: Kryesuesi Altin Gashi, 044 220 094, altingashi81@gmail.com. Zëvendës kryesuesi Xheladin Fazliu, 044 662 861, xh_fazliu@hotmail.com. ○*"Dardani"*: Kryesuesi Safet Kamberaj, 044 149 150, safetkamberaj@hotmail.com. Zëvendës kryesuesi Ismail Haliti, 044 809 087. ♦ **Fushë Kosovë** ○*"Fushë Kosovë/Kosovo Polje"*: Kryesuesi Bahri Bislimi, 044 435 705, bahribislimi84@hotmail.com. Zëvendës kryesuesi Sasha Zhiviq, 049 266 054, sasazivic@live.com ○*"Apollonia"*: Kryesuesi Adelinë Avdyli, 044 603 053, adelinaavdyli@hotmail.com. Zëvendës kryesuesi Ali Pllana, 044 249 104, ali.pllana@hotmail.com. ♦ **Lipjan** ○*"Janjevë"*: Kryesuesi Fehmi Gajtani, 044 345 109, fehmigajtani@live.com. Zëvendës kryesuesi Visar Bikliqi, 044 671 919, visar.bikliqi@gmail.com. ♦ **Graçanicë** ○*"Gushtericë e Ulët"*: Kryesuesi Zoran Simiq, 049 827 439, najacisamoostaju@gmail.com. Zëvendës kryesuesi Dejan Ristiq, 049 116 260. ○*"Llapllasellë - Çagllavicë - Preoc"*: Kryesuesi Slaviša Todić, 049 464 981, todic.s@hotmail.com. Zëvendës kryesuesi Aleksandra Dragović, 049 413 537. ○*"Sushicë - Kishnicë - Badoc"*: Kryesuesi Snezhana Jovanoviq, sneza_80@yahoo.com. Zëvendës kryesuesi Imri Ajeti, 044 441 420, luetrim.ajeti89@gmail.com. ♦ **Obiliq** ○*"Obiliq"*: Kryesuesi Burim Gërguri, 049 831 150, gerguriburim@gmail.com. Zëvendës kryesuesi Sejdi Haxholli, 044 875 731, sejdihaxholli@yahoo.com. ♦ **Podujevë** ○*"Kërpimeh"*: Kryesuesi Qefser Behrami, 044 166 673, qefserbehrami@hotmail.com. Zëvendës kryesuesi Sabit Rashiti, 044 844 133. ○"Orllan" Kryesuesi Nuhi Selimi, 044 163 413, vlora15@live.com. Zëvendës kryesuesi Islam Hasani, 044 171 173. ♦ Gllogoc ■ Telefoni kontaktues i Policisë së Kosovës: 192 ■ Kontakte anonime, të lira dhe konfidenciale në: 080019999 ■ info@kosovopolice.com ■ http://www.facebook.com/KosovoPolice

## INICIATIVAT E PROJEKTEVE TË KLSP-VE TË IMPLEMENTUARA NË RAJONIN E PRISHTINËS

♦ **Prishtinë** ○"Bërnicë e Poshtme": 2013: Ndriçimi i rrugës, 3,272 EURO. ○"Keqekollë": 2013: Rindërtimi i oborrit të shkollës së mesme, 2,600 EURO. 2014: Promovimi i sportit dhe rritja e stilit për një jetë të shëndetshme në mesin e të rinjve, 6,711 EURO. 2015: Përmirësimi i kushteve të sigurisë në oborrin e shkollës"Azemi e Salihu" në Dabishec, 2,311 EURO. ○"Prishtina Qendra": 2015: Përmirësimi i kushteve brenda kopshtit për zhvillimin e fëmijëve, 2,996 EURO. 2017: Kamerat e vëzhgimit, 5,905 EURO.○"Hajvali": 2014: Informimi i banorëve të Hajvalisë mbi rëndësinë e sigurisë së bashkësisë përmes tabelave të informacionit, 4,800 EURO. ○"Dardania": 2014: Krijimi i ambientit më të sigurt për të gjitha komunitetet përmes instalimit të kamerave të vëzhgimit, 1,904 EURO. 2015: Promovimi i sportit dhe stilit të jetesës së shëndetshme në mesin e të rinjve, 4,095 EURO. ♦ **Fushë Kosovë** ○"Fushë Kosovë": 2013: Vetëdijësimii publikut për sigurinë e shkollës, 2,000 EURO. 2014: Kampi ndër-etnik i të rinjve, 7,333 EURO. 2015: Kampi i përbashkët ndër-etnik me Lipën, 2016: Siguria e shkollës nëpërmjet instalimit të kamerave të vëzhgimit, 2,603 EURO. ○"Lagjja Apollonia": 2015: Siguria e shkollës nëpërmjet instalimit të kamerave të vëzhgimit, 3,069 EURO. ♦ **Lipjan** ○"Janjevë": 2013: Ndërtimi i parkut të fshatit, 2,967 EURO. 2014: Përmirësimi i kushteve të sigurisë brenda oborrit të shkollës lokale, 9,070 EURO. ♦ **Graçanicë** ○"Gushtericë e Ulët": 2013: Rindërtimi dhe renovimi i qendrës kulturore në Gushtericë e Ulët, 2,776 EURO. 2015: KLSP-të krijojnë besim dhe siguri përmes (instalimit të kamerave të vëzhgimit), 1,047 EURO. ○"Llapllasellë - Çagllavicë - Preoc": 2013: Vetëdijësimii publikut mbi KLSP-të dhe mbrojtja e mjedisit, 5,215 EURO. ○"Sushicë - Kishnicë - Badoc": 2013: Vetëdijësimii publikut mbi KLSP-të dhe mbrojtja e mjedisit, 5,215 EURO. 2014: Përmirësimi i infrastrukturës së sigurisë në trafik, 3,950 EURO. ♦ **Obiliq** ○"Obiliq": 2015: Krijimi i ambientit më të sigurt për të gjitha bashkësitë përmes instalimit të kamerave të vëzhgimit, 3,342 EURO. 2016: Kampi ndër-etnik i të rinjve, 6,950 EUR. ♦ **Podujevë** ○"Kërpimeh": 2017: Vetëdijësimi i nxënsëve për sigurinë në trafik, 2,636 EURO. ○"Orllan": 2017: Ndërtimi i fushës së volejbollit në shkollën lokale "Zahir Pajaziti", 5,198 EURO.



**Krpimeh, Siguria në trafik (2017)**



**Obiliq, Kampi i të rinjve (2016)**



**Orllan, Fusha e volejbollit (Para)**



**Orllan, Fusha e volejbollit (Pas)**

# RAJONI I PRIZRENIT



**INFORMACIONE THEMELORE:** Sipërfaqja totale është 1.706 km$^2$. Popullsia është 277.007 banorë. Stacionet e policisë: Prizreni, Suhareka, Mamusha dhe Dragashi, Njësia e Trafikut Rajonal që ndodhet në Prizren, dhe nënstacionet Sredskë, Zhur, Mushtishti dhe Krusheva. Mbulon territorin e katër komunave, duke përfshirë 152 fshatra, shumica prej të cilave janë shumë-etnike.



Me qëllim të shtimit të efikasitetit në lëmin e sigurisë dhe bashkëpunimit me komunitetin bashkëpunojmë me autoritetet e qeverive lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale. Bazuar në Strategjisë e Policimit në Bashkësi 2017-2021 synojmë ta shtojmë efektivitetin dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive tona. Kjo arrihet falë bashkëpunimit me qytetarët dhe kyçjes tonë në forumet e sigurisë, Këshillin Lokal për Siguri Publike.
**– nënkolonel Nexhmi Krasniqi, drejtor rajonal**



Siguria është e drejtë, jo privilegje, andaj Policia e Kosovës tërë potencialin e saj Intelektual, profesional dhe shkencor duhet ta orientoi kah qytetarët e Kosovës për mes formave të ndryshme por ajo më frytdhënëse është përmes "Policimit në Bashkësi" ku qytetari është drejtpërdrejtë i kyçur në zgjidhjen e problemeve duke aplikuar masat parandaluese. Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 të Policimit në Bashkësi ka për detyrë që të avancoi gjendjen aktuale të bashkëpunimit Polici-Bashkësi dhe të identifikoj problemet, pengesat, sfidat dhe në bashkëveprim me partnerët, të avancoj metodat më bashkëkohore për Strategjinë.
**– nënkolonel Musli Kololli, zëvendës drejtor rajonal.**



Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale. Përmes zbatimit të Strategjisë së Policimit në Bashkësi, Policia e Kosovës synon që të siguroj efikaset dhe efektivitet në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të saj në policimin në bashkësi. Kjo punë arrihet fal bashkëpunimit me forumet e sigurisë, OJQ-ve si dhe mediave. Policia e Kosovës është një partner esencial në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. Gjithashtu, Policia e Kosovës me veprimet e saja dhe në ndërveprim me bashkësinë për së afërmi e përcjell hulumtimin e opinionit publik, si një mjet i cili e bënë matjen e nivelit të besueshmërisë ndaj shërbimit të policisë.
**– rreshter Vesel Gashi, koordinator i policisë në bashkësi.**



Niveli i bashkëpunimit mes KLSP-së tonë dhe policimit në bashkësi është shumë i kënaqshëm. Ne mbajmë takime të rregullta dhe shkëmbejmë informacion mbi gjendjen e sigurisë në të gjitha vendet e zonës sonë, me qëllim të përmirësimit të stabilitetit të përgjithshëm.
**– Nehat Vehapi, kryesuesi i KLSP-së nga Lubizhda.**



Policia i kryen detyrat e tyre në mënyrë shumë profesionale, sepse ata rrjedhin nga njerëzit dhe punojnë me njerëzit. Ne kemi arritur ti zgjidhim problemet përmes dialogut në takimet tona me KLSP-në.
**– Behar Brenolli, kryesuesi i KLSP-së nga Krusheva.**

# PRIZREN



1. "Mushnikovë", Prizren
2. "Lubizhdë", Prizren
3. "Krushevë", Dragash

**Gjithsej anëtarë** 26 **Meshkuj** 24 **Femra** 2

**Gjithsej projektet e financuara (2013 - 2017)** 27.765 EURO nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze e të implementuara përmes OSBE-së

## INICIATIVAT E PROJEKTEVE TË KLSP-VE TË IMPLEMENTUARA NË RAJONIN E PRIZRENIT

